



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.01.2021, ora 09:30

**Drejton mbledhjen:**

**Ramazan Gjuzi - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Njohja dhe diskutimi i informacionit të Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura për vakancat në KDRTSH.
2. Rishpallja e 2 vendeve vakante për KDRTSH (*vendimet nr. 1 dhe 2/ 2021*).

**Marrin pjesë:**

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Enada Kapllani, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Alma Barova dhe Erion Piciri.

## HAPET MBLEDHJA

**Ramazan Gjuzi** – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për materialin e ardhur nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në lidhje me vakancat në KDRTSH.

Më parë të fillojmë me prezencën: Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Enada Kapllani, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Alma Barova dhe Erion Piciri.

Atëherë nga memo e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ...

**Bujar Çela** – Zoti kryetar, a mundem?

**Ramazan Gjuzi** – Po.

**Bujar Çela** – I uroj ditëlindjen kolegut tonë Jenishehri!

**Ramazan Gjuzi** – Edhe 100 zotit Jenishehri!

**Selami Jenishehri** – Faleminderit shumë!

**Ramazan Gjuzi** – Këshilli Drejtues i RTSH-së është i përbërë nga 10 anëtarë dhe një kryetar. Momentalisht rezulton me 7 anëtarë dhe kryetarin e tij, të cilit i ka përfunduar mandati dhe procedurat për zgjedhjen e tyre akoma nuk janë përfunduar nga Kuvendi. Për vakancat e zotërinjve Elidon Haliti, Pashk Përvathi dhe Artan Peqini, të cilët kanë pasur një mandat 3-vjeçar, komisioni shpalli vakancat në dhjetor 2017 dhe në prill 2018, ndërsa zhvilloi seancën dëgjimore publike me kandidatët e propozuar nga subjektet, që parashikon ligji në datën 4 shkurt 2019, pothuajse një vit nga shpallja e vakancave.

Në përfundim të seancës dëgjimore komisioni zgjodhi me vendimet nr. 7, 8 dhe 9 tre kandidatë për anëtar të KDRTSH-së: zotin Besnik Mustafaj, Edmond Tullumani dhe Elidon Haliti. Vendimet e komisionit iu përcollën seancës plenare dhe për disa kandidatë nuk është bërë marrja e vendimit përfundimtar nga Kuvendi.

Për vakancën e zotit Sajmir Kumbaro, i cili ka pasur një mandat 5-vjeçar, komisioni shpalli vakancën në maj të vitit 2019 me vendimin nr. 10 të tij dhe në përfundim të afatit të dorëzimit të dokumentacionit numri i kandidatëve të paraqitur nuk e plotësonte numrin minimal të kandidatëve për një vend vakant të përcaktuar në dispozitat e nenit 94, pika 3 e ligjit. Komisioni në vijim duhet të marrë vendim për rishpalljen e kandidaturës, të rikandidimit përsëri, derisa të plotësohet numri minimal i kandidatëve.

Për vakancat e zotërinjve Kristaq Traja, Robert Rakiplari, Vladimir Grosha dhe Altin Shegani, të cilët kanë pasur mandat 5-vjeçar, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik nëpërmjet vendimeve nr. 11, 12, 13 dhe 17 ka shpallur në datën 5 qershor 2020 vakancat e kryetarit dhe të tre anëtarëve të tjerë të Këshillit. Në përfundim të afatit të dorëzimit, rezultuan 12 kandidatura të propozuara nga subjektet që ngarkon ligji dhe konkretisht: Ardita Reçi, Genc Tomço, Laureta Roshi, Mevlan Shanaj, Ëngjëll Ndocaj, Krenar Hajdëri, Arjan Sukniqi, Vitore Shkreli, Ervin Nuriu, Rafaela Rica, Suela Milo dhe Petrit Ruka. Kandidaturat e propozuara nga subjektet që ngarkon ligji kanë shprehur interes për të kandiduar në vendet vakante të tre anëtarëve, ndërsa për vendin vakant të kryetarit të KDRTSH-së nuk është paraqitur asnjë kandidaturë. Komisioni në vijim ka detyrimin të rishpallë edhe një herë vakancën e kryetarit të KDRTSH-së, si dhe të vijojë procedurën për zhvillimin e seancës dëgjimore me kandidatët e propozuar për anëtarë të rinj të Këshillit.

***Mbyllet pika e parë e rendit të ditës***



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.01.2021, ora 09:40

**Drejton mbledhjen:**

**Ramazan Gjuzi - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

2. Rishpallja e 2 vendeve vakante për KDRTSH (*vendimet nr. 1 dhe 2/ 2021*).

**Marrin pjesë:**

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Enada Kapllani, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Alma Barova dhe Erion Piciri.

***Vijon pika e dytë e rendit të ditës***

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në mbarim të mandatit të zotit Sajmir Kumbaro, si anëtar i KDRTSH-së, në zbatim të nenit 94, pika 2 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” duhet të vendosë për rishpalljen e këtij vendi vakant.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në mbarim të mandatit të zotit Kristaq Traja si kryetar i KDRTSH-së, në zbatim të nenit 95, pika 2 të ligjit nr. 97/2013 “Për

mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” duhet të vendosë për rishpalljen e këtij vendi vakant.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në vijim duhet të bëjmë një kalendar për dëgjesat me 12 kandidatët, që kanë paraqitur kërkesat për anëtar të KDRTSH-së.

Kush e do fjalën?

**Fatjona Dhimitri** – Mundem, zoti kryetar?

**Ramazan Gjuzi** – Po, zonja Dhimitri.

**Fatjona Dhimitri** – Faleminderit!

Meqenëse u shpallën dhe vakancat për kryetar, dëshiroj të sjell dhe në vëmendjen tuaj faktin që kandidatura e zotit Besnik Mustafaj vijon të qëndrojë e ngrirë në Kuvend. Nuk e kuptoj këtë gjë. E kam kërkuar disa herë dhe procedura vijon të qëndrojë pezull.

Unë e kuptoj që ndokush aty mund të thotë që është një kandidaturë e propozuar para 2 vjetësh, por kandidatura e zotit Mustafaj nuk ka kuptim të mos shkojë më në seancë plenare dhe të votohet në Kuvend! Zotëria është dëgjuar në komision, me sa di, dhe nuk ka pasur asnjë lloj problemi përse procedura të mos vijojë normalisht.

**Mirela Kumbaro** – Kryetar, a mundem?

**Ramazan Gjuzi**- E mbyllëm procedurën me...

Po, zonja Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** – Për sa i përket procedurës për kalendarin, meqenëse ne kemi tashmë 12 kandidatura të depozituara, propozoj që nuk kemi pse të humbasim kohë dhe të biem dakord për një datë, ndoshta edhe të premtën, po të doni, ose të hënën që vjen, për të zhvilluar intervistat. Nëse kolegët janë dakord, unë propozoj që të hënën që vjen, kur data do të jetë 1 shkurt, të procedojmë me intervistat. Gjithashtu, do t’i kërkoja...

**Ramazan Gjuzi** – Hiqeni kufjen, sepse nuk dëgjoheni mirë.

**Mirela Kumbaro** – ...sekretarisë dhe Shërbimit të Monitorimit t’u bënin një verifikim 12 kandidaturave, sepse, me sa kuptova, ato janë depozituar 1-2 vjet më parë. Kështu që, në këtë kontekst, do t’i kërkoja Shërbimit të Monitorimit të bënte një verifikim për kandidaturat, nëse janë të interesuara të mbeten të tilla. Nëse po, ato që mbeten ose 12 kandidaturat, t’i marrim në intervistë dhe të zhvillojmë seancën dëgjimore, të parashikuar nga ligji dhe ta bëjmë këtë në datën 1 shkurt, pra të hënën tjetër.

A jeni dakord me këtë?

**Erion Piciri** – Nëse ka mundësi, të lihet në një ditë tjetër, përveç të hënës, sepse kam mësim.

**Mirela Kumbaro** – A mund ta bëjmë ditën e martë, në datën 2 shkurt? Nuk duhet të zgjatet më shumë, sepse pastaj ne të gjithë shpërndahemi nëpër zona, për hir të së vërtetës.

**Ramazan Gjuzi** – Zonja Kumbaro, në datën 3 shkurt, në orën 10:30, kemi ballafaqimin me ministren e Arsimit dhe e kemi marrë konfirmimin nga ministrja, që është e disponueshme. Kështu që, po ta lëmë në datën 3...

**Mirela Kumbaro** – Jo në datën 3, se kemi ministren. Ose në datën 1, ose në datën 2, si të...

**Ramazan Gjuzi** – Zoti Piciri thotë që në datën 1 nuk mundet...

**Mirela Kumbaro** – Zoti Ulqini ka një pyetje, më duket.

**Ramazan Gjuzi** – Po, zoti Ulqini.

**Musa Ulqini** – Në qoftë se seanca me zonjën ministre nuk është shumë e gjatë, atëherë ne mund t'ia kushtojmë gjithë ditën e mërkurë mbledhjes së komisionit, në mënyrë që të mos pengohemi në aktivitetet që kemi nëpër zona. E kam si sugjerim këtë.

**Mirela Kumbaro** – T'i bëjmë të dyja në një ditë?

**Musa Ulqini** – Po, t'i bëjmë në një ditë dhe të konsiderohen 2 mbledhje, sepse e lejon dhe procedura.

**Mirela Kumbaro** – Po, e di.

**Ramazan Gjuzi** – Lëmë një orar tjetër.

**Mirela Kumbaro** – A ka ndonjë orar nga zonja ministre?

**Ramazan Gjuzi** – Në orën 10:30 e kemi.

**Musa Ulqini** – Mbarojmë për një orë dhe pastaj vazhdojmë...

**Mirela Kumbaro** – Ne mund ta shfrytëzojmë ditën dhe më herët. T'i fillojmë intervistat në orën 09:00-10:30, vazhdojmë me ministren dhe më pas nga ora 11:30 e deri në vazhdim me intervistat. A jeni dakord kështu?

**Musa Ulqini**- Shumë mirë.

**Ramazan Gjuzi** – Kush është dakord që ta bëjmë ditën e mërkurë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Atëherë ta lëmë ditën e mërkurë dhe për orarin do t'ju njoftojmë nëpërmjet sekretarisë.

**Mirela Kumbaro** – Dakord.

Për sa i përket pyetjes së zonjës Dhimitri, dua t'ju kujtoj që janë tri kandidatura. Nuk është vetëm kandidatura në fjalë, janë edhe zotit Tullumani, në mos gaboj, dhe zoti Haliti.

Të tria kandidaturat kanë kaluar me të njëjtën procedurë, e sjell këtë thjesht për kujtesë në vëmendje, se, në fakt, e kishit të shkruar edhe në *memo*-n e Shërbimit të Monitorimit. Jua sjell në vëmendje këtë, sepse ka që në janar të vitit 2019. Të tria kandidaturat i kanë kryer procedurat dëgjimore dhe procedurën e votimit në komision, në janar të 2019-s, dhe janë

përcjellë në seancë plenare për procedurë parlamentare. Kështu që, zoti Ulqini, që është më me përvojë se unë në çështjet e procedurave, mund të më korrigjojë, ata tashmë janë në procedurë parlamentare dhe, si të thuash, kanë kaluar çdo lloj hapi që mund të bëhet në komision, pra ne as e pengojmë, as e nxisim. Zoti Ulqini, a e kam të saktë komentit?

**Musa Ulqini** – 100% të saktë.

**Mirela Kumbaro** – Kjo ishte për ta sjellë në vëmendje të të gjithëve. Pra, nuk bëhet fjalë për një, por për të tre bashkë, që janë tashmë në “derë” të seancës parlamentare.

**Ramazan Gjuzi** – Verifikimi nga Shërbimi i Monitorimit është bërë për kandidaturat. Kështu që ne jemi dakord me...

**Mirela Kumbaro** – Cila është përgjigjja? A janë të 12 kandidaturat të disponueshme për...?

**Ramazan Gjuzi** – 12 kandidaturat janë verifikuar nga Shërbimi i Monitorimit.

**Mirela Kumbaro** – Dakord. Nuk e dija. Shumë mirë.

Atëherë, procedojmë ashtu siç ramë dakord, në qoftë se nuk ka ndonjë kundërshtim tjetër.

**Ramazan Gjuzi** – Atëherë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ditën e mirë!

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Shërbimi i Monitorimit do të na bëjë njoftimin dhe do të na sjellë materialin në faqen zyrtare për shpalljen e vakancave.

Mirupafshim!

## **MBYLLET MBLEDHJA**